


"HASAN PRISHTINA"
REKTORATI

Pranuar me dt. 16.5.2018			
Nj. org.	Numër	Nr.ekzempl.	Vlera
01	1/385		



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MES

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK)

DHE

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS (UP)

"HASAN PRISHTINA"

Prishtinë, 14.05.2018

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është vendosja e bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Universitetit të Prishtinës (UP), për kryerjen e ekspertizave dhe super ekspertizave nga ana e ekspertëve të Fakulteteve të Universitetit të Prishtinës për nevojat e Prokurorit të Shtetit.
2. Bashkëpunimi reciprok i palëve nënshkruese i kësaj marrëveshje bëhet me qëllim të përkrahjes së proceseve për avancimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Neni 2

Fushë veprimtaria

1. Bashkëpunimi në mes të KPK-së dhe UP-së, do të fokusohet në kryerjen e ekspertizave dhe super ekspertizave nga ana e ekspertëve të Fakulteteve të UP-së, pas pranimi të kërkesës (vendimit nga ana e prokurorive si në qendër po ashtu edhe në regjione, për kryerjen e ekspertizës).

Neni 3

Universiteti i Prishtinës

1. Universiteti i Prishtinës (UP) do t'i përmbahet obligimeve dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. UP do t'i ofroj bashkëpunim dhe mbështetje KPK-së nga përvojat, ekspertizat dhe resurset njerëzore që disponon.
3. UP do të respektoj parimin e konfidencialitetit, pavarësinë e sistemit prokurorial si dhe parimin e qasjes profesionale, shkencore dhe analitike gjatë procesit të kryerjes së ekspertizës/super ekspertizës.
4. UP është i obliguar t'u përmbahet afateve të caktuara nga prokurori i çështjes, sipas vendimit në bazë të të cilit i është besuar ekspertiza.

Neni 4
Prokurori i Shtetit

1. Prokurori i Shtetit do të kërkoj ekspertizë nga fakultetet e UP sipas rastit të përcaktuar me vendim.
2. Prokurori i Shtetit kërkon nga UP që të caktoj ekspertin nga regjistri i ekspertëve të UP-së, në fushën e caktuar për kryerjen e ekspertizës.
3. Prokurori i Shtetit e dërgon me kohë vendimin së bashku me shkresat e lëndës për kryerjen e ekspertizës/super ekspertizës tek eksperti të cilit ia beson ekspertizën.
4. Prokurori i Shtetit sipas nevojës jep sqarime dhe udhëzime shtesë ekspertit/ekspertëve.

Neni 5
Pagesat e ekspertëve

1. Pagesat e ekspertëve, për shërbimet e ofruara, do të rregullohen me akt të veçantë të vendosur me pajtimin e palëve të kësaj marrëveshjeje.


Neni 6
Dispozitat e fundit

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme deri sa palët nuk vendosin ndryshe.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit do të plotësohet apo ndryshohet sipas nevojës me ndonjë marrëveshje të veçant me shkrim nga ana e palëve.
3. Cdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me interpretimin, menaxhimin apo ekzekutimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të zgjidhet me mirëkuptim në mes palëve.

Për: Këshillin Prokurorial të Kosovës

Blerim Isufaj, Kryesues

Prishtinë



Për: "UP "Hasan Prishtina"-Prishtinë

Prof. Dr. Mafian Dema, Rektor

1970 Prishtinë

